

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-138/13**

**Prishtinë,  
23 prill 2014**

Në çështjen juridike të:

**H.Q**

***Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese***

kundër.

**A.A**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numrin KPA01183), të datës 22 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 23 prill 2014, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e H.Q.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA01183), i datës 22 tetor 2012.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 31 tetor 2007, pala ankuese, më parë paraqitësi i kërkesës H.Q, ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së tij të shfrytëzimit të një banese prej 54 metrave katrorë, në rrugën “Marshal Tito” nr. 35, tani rruga “Skenderbeu”.
2. Ai ka pretenduar se prona i ishte dhënë në shfrytëzim me kontratë babait të tij në vitin 1966 dhe se ai e kishte shfrytëzuar atë pandërprerë deri në vitin 1984 kur një person tjetër e kishte uzurpuar atë pa pasur të drejtë në këtë. Personi tjetër e kishte shfrytëzuar banesën deri në vitin 1999.
3. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur para Komisionit një kontratë të vitit 1966. Sipas saj, babait të paraqitësit të kërkesës (Š.T) i ishte dhënë e drejta e shfrytëzimit të banesës, që ishte pronë e ish-Ndërmarrjes Komunale Banësore<sup>1</sup> në Istog. Ekzistenca e kësaj kontrate dhe lidhja familjare ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe përfituesit në këtë kontratë – të lartpërmendurit Š.T, nuk kontestohen.
4. Nuk është kontestuese se familja e paraqitësit të kërkesës e kishte shfrytëzuar këtë banesë deri në vitin 1984.
5. Nuk është kontestuese se pas vitit 1984, dhe para konfliktit të viteve 1998/1999, prona ishte shfrytëzuar nga persona tjerë.
6. Nuk është relevante për rastin aktual se mbi çfarë baze këta individë e kishin shfrytëzuar pronën në fjalë pas vitit 1984 e deri në konfliktin e armatosur.
7. Është bërë njoftimi i pronës dhe pala përgjegjëse në kërkesë A.A është gjetur ta ketë uzurpuar atë. Ajo nuk kërkon ndonjë të drejtë ndaj pronës. Ajo ka sqaruar se kur ishte futur në pronë në vitin 1999, ajo kishte qenë e lirë.

---

<sup>1</sup> “Stambeno Komunalno Preduzeće” në gjuhën origjinale të kontratës, që ishte gjuha serbe

8. KKKPK-ja e ka hedhur poshtë kërkesën. KKKPK-ja ka pranuar se lënda nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999.
9. Vendimi iu dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 23 prill 2013. Ai ka paraqitur ankesë më 16 maj 2013.
10. Pala përgjegjëse në kërkesë nuk është përgjigjur në ankesë.

**Pretendimet e palës ankuese:**

11. Pala ankuese pohon se vendimi është i pabazuar. Ekzistojnë prova që dëshmojnë se babait të tij T.Q i ishte dhënë e drejta e shfrytëzimit të banesës në vitin 1966. Në vitin 1984, banesa ishte uzurpuar pa bazë ligjor nga B.B i cili kishte jetuar në të deri në vitin 1999. Pas kësaj, A.A e kishte uzurpuar banesën. Si trashëgimtar ligjor i T.Q, ai ka të drejtë që të kërkojë ri-posedimin kundrejt uzurpatorit aktual.

**Arsyetim ligjor:**

**Pranueshmëria e ankesës:**

1. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (në tekstin e mëtejme Ligji 03/L-079).

**Meritat:**

12. Ankesa është pabazuar.
13. Sipas nenit 3.1 të Ligjit, Komision ka kompetencë që të zgjidh kërkesat lidhur me të drejtat që nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
14. Në rastin aktual, posedimi i pronës ishte humbur në vitin 1984 (vetë paraqitësi i kërkesës e pohon këtë fakt), që do të thotë se kërkesa nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999. Prandaj, Komisioni me të drejtë e ka hedhur poshtë kërkesën pasi që ajo është jashtë juridiksionit të saj.

15. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të ligjit 03/L-079, Gjykata vendosi si në dispozitiv.

**Këshillë ligjore:**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it**

**Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**